

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË**P. Nr. 40/08****21 tetor 2010****NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË, me trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati si Kryetare e Trupit Gjykues, dhe Gjyqtarët e EULEX-it Caroline Charpentier dhe Nikolay Entchev si anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e Oficeres Ligjore të EULEX-it Tara Khan si Proçesmbajtëse, në çështjen penale kundër;

Kushtrim HAZIRAJT, fillimisht akuzuar për veprën penale të Vrasjes së Rëndë, në kundërshtim me Nenin 147, Pika 4 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), Tentativë për Vrasje të Rëndë, në kundërshtim me Nenin 147, Pika 4 të lexuar me Nenin 20 të KPPK dhe veprën penale të Pronësia, Kontrolli, Posedimi apo Përdorimi i Paautorizuar i Armës, në kundërshtim me Nenin 328, Paragrafi (2) të KPPK, sipas Aktakuzës së Prokurorit Publik të Qarkut, PP. Nr. 235/07, që mban datën dhe që është dorëzuar më 29 janar 2008,

Pasi është mbajtur seanca publike që ka të bëjë me Marrëveshjen mbi Pranimin e Fajësisë, më datën 20 tetor 2010, më 20 tetor 2010, në praninë e të akuzuarit Kushtrim Haziraj, Avokates ëë tij Mbrojtëse Kosovare Kelmendi, Prokurorit Publik të EULEX-it Adebayo Kareem dhe Palëve të Lënduara Liridon Geci, Gani Geci, Hida Geci, Përfaqësuesit Ligjir të Palës së Lënduar Liridon Geci, Agim Lushta, pasi është pranuar Marrëveshja mbi Fajësinë në të njëjtën datë dhe pasi ajo është regjistruar në Gjykatë më 20 tetor 2010, dhe pasi është mbajtur séance publike që ka të bëjë me dënimin, më datën 21 tetor 2010, në praninë e të Akuzuarit, Avokates së tij Mbrojtëse, Prokurorit Publik të EULEX-it, Palëve të Lënduara Gani Geci dhe Hida Geci, pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur më datën 21 tetor 2010, në bazë të Nenit 308A, Paragrafi (15) të Kodit të Proçedurës Penale të Kosovës (KPPK), shpalli në publik dhe në praninë e të Akuzuarit, Avokates së tij Mbrojtëse, Prokurorit Publik të EULEX-it dhe Palëve të Lënduara, si më poshtë vijon:



AKTGJYKIM

I akuzuari **Kushtrim Haziraj**, djali i Sadik Hazirajt dhe Drita Havollit, lindur më 10 dhjetor 1984, në Skënderaj, shqiptar kosovar, banor në fshatin Llaushë, i martuar, pa fëmijë, niveli më i lartë i arsimit shkolla e mesme, punëtor me profesion, me të ardhura përafërsisht 200 Euro/në muaj, në paraburgim që nga data 22 gusht 2007,

Pasi ka pranuar fajësinë për veprat penale të Vrasjes, në kundërshtim me Nenin 146 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), Tentativës për Vrasje, në kundërshtim me Nenin 146 të lexuar me Nenin 20 të KPK dhe veprës penale të Pronësisë, Kontrollit, Posedimit apo Përdorimit të Paautorizuar të Armëve, në kundërshtim me Nenin 328, Paragrafi (2) të KPK, sipas Marrëveshjes mbi Pranimin e Fajësisë të datës 20 tetor 2010, dhe pasi Gjykata e ka pranuar Marrëveshjen mbi Pranimin e Fajësisë së datës 20 tetor 2010, si të regjistruar në Gjykatë më 20 tetor 2010,

DËNOHET

- me 10 /dhjetë/ vjet burgim për veprën penale të Vrasjes
- me 4 /katër/ vjet burgim për veprën penale të Tentativës për Vrasje
- me 1 /një/ vit burgim për veprën penale të Pronësisë, Kontrollit, Posedimit apo Përdorimit të Paautorizuar të Armëve.

Dënimi unik përcaktohet me **13 /trembëdhjetë/ vjet burgim**, sipas Nenit 71, Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2), Pika 2 e KPK.

Koha e kaluar në paraburgim që nga data 22 gusht 2007 do të përlllogaritet, sipas Nenit 73, Paragrafi (1) të KPK.

Arma AK-47, e kalibrit 7,62, me numrin e serisë 039575, do të konfiskohet, sipas Nenit 60, Paragrafi (1) dhe Nenit 328, Paragrafi (5) të KPK.

I akuzuari do të riimbursojë shpenzimet e procedurës penale, sipas Nenit 102, Paragrafi (1) të KPPK, me përjashtim të shpenzimeve për përkthimin me gojë dhe me shkrim. Një vendim i veçantë lidhur me sasinë e shpenzimeve do të dorëzohet nga gjykata, pasi të merrm ëto të dhëna, në bazë të Nenit 100, Paragrafi (2) të KPPK.



ARSYETIMI

A. PREJARDHJA PROÇEDURIALE

Prokurori Publik i Qarkut të Mitrovicës, në Aktakuzën PP. no. 235/07, të datës 29 janar 2008, e ka akuzuar Kushtrim Hazirajn për veprat penale të Vrasjes së Rëndë, në kundërshtim me Nenin 147, Pika 4 e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), Tentativës për Vrasje të Rëndë, në kundërshtim me Nenin 147, Pika 4 e lexuar me Nenin 20 të KPPK, dhe Pronësisë, Kontrollit, Posedimit apo Përdorimit të Paautorizuar të Armëve, në kundërshtim me Nenin 328, Paragrafi (2) të KPPK.

Gjykimi kryesor ishte caktuar të fillonte më datën 18 tetor dhe do të vazhdonte më datat 19, 20 dhe 21 tetor 2010, por fillimi i gjykimit u shty për shkak të negociatave të vazhdueshme lidhur me fajësinë mes palëve. Më 20 tetor 2010, Prokurori i EULEX-it e informoi Gjykatën se më në fund ishte arritur një marrëveshje mbi pranimin e fejësisë mes palëve, e cila ishte firmosur nga palët dhe nga Kryeprokurori Publik.

B. KOMPETENCA E GJYKATËS

Sipas Nenit 23, Pika 1) i) të KPPK, gjykatat e qarkut janë kompetente për të dëgjuar veprat penale që përfshijnë akuza për të cilat ligji parasheh vendosjen e dënimeve penale prej të pakten pesë vjetësh. Sipas Nenit 27, Paragrafi (1) të KPPK, juridiksioni territorial është i saktë për atë gjykatë në qarkun ku aludohet se ka ndodhur vepra penale.

Siç është përcaktuar më sipër, akuza e Vrasjes së Rëndë, sipas Nenit 147 të KPK, lejon për vendosjen e një dënimi minimal burgimi prej 10 vjetësh. Përveç kësaj, aktakuza në këtë çështje aludon se i akuzuari i kishte kryer veprat penale në Skënderaj.

Prandaj, Gjykata e Qarkut të Mitrovicës është organi kompetent gjyqësor për ta dëgjuar këtë procedurë penale.

Më 2 gusht 2010 Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ia caktoi çështjen gjyqtarëve të EULEX-it, duke u bazuar në Nenin 3.3 të Ligjit mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve, Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it.

Prandaj, Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, janë kompetentë për të shqyrtuar këtë çështje penale. Trupi gjykues ishte i përbërë nga Gjyqtarja Penaliste e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati, si Kryetare e Trupit Gjykues dhe Gjyqtarët e EULEX-it Caroline Charpentier dhe Nikolay Entchev, si anëtarë të trupit gjykues. Që të tri gjyqtarët janë emëruar në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.



Asnjë nga palët nuk e kundërshtoi përbërjen e trupit gjykues.

C. MARRËVESHJA MBI FAJËSINË

Marrëveshja mbi Fajësinë iu paraqit Gjykatës në seancën publike, sipas Nenit 308A, Paragrafi (9) të KPPK, më 20 tetor 2010.

I akuzuari Kushtrim Haziraj e pranoi fajësinë për veprën penale të Vrasjes, në kundërshtim me Nenin 146 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), për veprën penale të Tentativës për Vrasje, në kundërshtim me Nenin 146 të lexuar me Nenin 20 të KPPK, dhe për veprën penale të Pronësisë, Kontrollit, Posedimit apo Përdorimit të Paautorizuar të Armëve, në kundërshtim me Nenin 328, Paragrafi (2) të KPPK (siç është korrigjuar gjatë seancës).

Marrëveshja mbi Fajësinë përmbante përfundimet e mëposhtme faktike:

Më 19 gusht 2007, rreth orës 17:20, i pandehuri Kushtrim Haziraj u përfshi në një zënkë me Jeton Gecin bashkë me dy nga kushërinjtë e Jetonit, dhe u raportua që Kushtrimin e kishin rrahur. Pas zënkës, Kushtrimi e raportoi incidentin tek xhaxhai i tij, Ramiz Haziraj, i cili e mori me makinën e tij dhe e çoi në stacionin vendor të policisë, në Skenderaj, ku incidenti u raportua formalisht. Në kohën kur ndodhi incidenti, Ramiz Haziraj ishte një koleg pune dhe shok i Sabit Gecit, që është xhaxha i Jeton Gecit. Prandaj, Ramizi vendosi të bisedonte me Sabit Gecin me qëllim që të gjente mënyrat për t'u siguruar që ky incident të mos përsëritej. Që të dy, Ramizi dhe Sabiti ranë dakort të takoheshin më vonë në mbrëmjen e së njëjtës ditë për të diskutuar çështjen. Ata u takuan më vonë, në orën 19:30 tek një restorant në Skënderaj. Në atë takim ishin Ramiz Haziraj, Ajet Haziraj {që është vëllai i Ramizit}, Sabit Geci dhe Kushtrim Haziraj, pavarësisht se Kushtrimi më vonë u largua për të takuar një shok të tij aty afër. Në takim palët i kërkuan falje njëri-tjetrit dhe ranë dakort të bisedonin me më të rinjtë, me qëllim që mes tyre të mos kishte më probleme. Më pas Hazirajt u larguan për të shkuar në makinën e tyre, ndërsa Sabiti shkoi të bisedonte me nipërit e tij, që ishin gjithashtu në një kafene aty afër. Ndërkohë që Hazirajt ishin në makinën e tyre duke shkuar në shtëpi, Ajeti e kuptoi se kishte nevojë të blinte cigare dhe i kërkoi Ramizit të ndalonte e të parkonte makinën. Në atë moment Kushtrimi mori një mesazh telefonik për të takuar një shokun e tij aty afër. Që të dy, si Ajeti ashtu edhe Kushtrimi, më pas dolën nga makina. Ndërsa Kushtrimi ishte rrugës për të takuar shokun e tij, ai takoi Adnan Gecin dhe Liridon Gecin. Këta ishin personat që e kishin rrahur atë më parë atë ditë që kishte shkëmbyer fjalë ofenduese me Adnanin, i cili më vonë, u përfshi në zënkën mesa tyre të dyve. Ndërkohë që kjo zënkë po vazhdonte, Liridoni vrapoi që të merrte në telefon kushërinjtë e tij të tjerë, që ishin aty afër, për t'u treguar atyre për zënkën. Këta kushërinjtë e tjerë, rreth 4-7 prej tyre erdhën me nxitim në vendin e ngjarjes. Ata përfshinin Jeton Gecin, Izedin Gecin, Sabit Gecin, Liridon Gecin dhe Ramiz Hazirajn. Kushtrim, pasi i pa që ata po vinin dhe që ata ishin më shumë në numër se ai, u largua me vrap në makinën e xhaxhait të tij që ishte e



parkuar aty pranë. Ka prova dhe pranime nga anëtarët e familjes Geci që ata e ndoqën Kushtrimin në mënyrë kërcënuese kur ai po vraponte drejt makinës së xhaxhait të tij. Edhe Liridon Geci e pranon, po ashtu, se ‘Unë e nxorra armën nga ana e djathtë e mesit dhe ia drejtova atë Kushtrimit {dhe bërtita}: ‘Qëlllo, të bëfsha nënën! Ti nuk je burrë...E nxorra armën për ta frikësuar atë dhe jo për ta gjuajtur...’

Pavarësisht se Liridoni deklaroi se ai e nxorri armën pasi i pandehuri kishte nxjerrë armën e tij, i pandehuri e kundërshtoi këtë duke thënë se Liridoni e kishte nxjerrë armën i pari. Nuk ka asnjë provë tjetër që të mbështesë deklaratat e tyre. Sidoqoftë, pasi Kushtrimi hyri në makinën e xhaxhait të tij, ai nxorri pushkën {të cilën e mbante aty, duke, sipas tij, e përdorur atë në një dasëm vetëm disa ditë më parë}, dhe kërcënoi turmën me të. Duke u përballur me armën e Liridonit, dhe jo në një pozitë për të ditur që arma nuk ishte e mbushur me plumba, ai qëllloi mbi të. Megjithatë, ai nuk e qëlloi Liridonin dhe në vend të tij, plumbi goditi Jashar Gecin, që nuk ishte i përfshirë në ndonjë mosmarrëveshje me Kushtrimin. Duke e parë këtë, xhaxhai i Kushtrimit, vrapoi për tek ai që ta çarmatoste dhe në një përpjekje për ta bërë këtë, u godit nga një e shtënë nga arma e Kushtrimit, duke u plagosur në shpatull. Më vonë, Jashari vdiq në Qendrën Klinike Universitare.

Palët e lënduara Gani Geci – babai i viktimës Jashar Geci (që përfaqëson gjithashtu edhe Ibadete Gecin, gruan e viktimës), Hida Gecin – nënën e viktimës, Liridon Gecin – Palë e lënduar lidhur me akuzën për veprën penale të Tentativës për Vrasje, dhe Përfaqësuesi i tyre ligjor, Agim Lushta morën pjesë në seancën publike të datës 20 tetor 2010. Palët e Lënduara konfirmojnë se ata ishin informuar nga prokurori lidhur me Marrëveshjen mbi Fajësinë.

Në bazë të Nenit 308A, Paragrafi (5) të KPPK, Palës së Lënduar duhet t’i jepet mundësia të paraqesë një deklaratë në gjykatë lidhur me padinë pronësore. Në çështjen në fjalë, asnjë nga Palët e Lënduara – pasi u janë dhënë udhëzimet përkatëse dhe pasi u është shpjeguar që ç’do të thoshte padi pronësore – nuk kanë dorëzuar një padi të tillë. Atyre iu është dhënë mundësia të prezantojnë komentet e tyre lidhur me marrëveshjen mbi fajësinë, ku Liridon Geci shprehu pakënaqësinë e tij me dënimin e propozuar.

Marrëveshja mbi Fajësinë është pranuar nga Gjykata ditën që u zhvillua séance, sipas Nenit 308A, Paragrafi (10) dhe (15) të KPPK, me korrigjimet e mëposhtme:
Në krye të faqes 3 të kualifikimit të akuzës për armën duhet lexuar si – Neni 328, Paragrafi (2) i KPPK, në vend të Nenit 326 të KPPK,
Nën pikën 4, në të njëjtën faqe on the same page pika e tretë bullet point: Neni 328, Paragrafi (2) i KPK, në vend të Nenit 328 të KPK,
Në faqen 4, Gjendja Faktike, data e veprës penale duhet lexuar si 19 gusht 2007, në vend të 27 gusht 2007.
Korrigjimet janë miratuar nga palët dhe kanë hyrë në procesverbalin e seancës.

Pa marrjes në pyetje të të Akuzuarit, nga Avokati i tij Mbrojtës dhe Prokurori Publik, Gjykata vendosi që Marrëveshja mbi Fajësinë i plotësonte kushtet e Nenit 308A, Paragrafi (12); I Akuzuari e kuptoi natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, në mënyrë



vullnetare ai bëri pranimin e fajësisë pasi u konsultua në mënyrë të mjaftueshme me avokatin e tij mbrojtës, ai nuk u shtrëngua në asnjë mënyrë dhe nuk u detyrua të pranonte fajësinë. Për më tepër, pranimi i fajësisë, mbështetet nga faktet dhe provat e çështjes, dëshmitë e dëshmitarëve, dëshmitë e të Akuzuarit dhe provat dokumentuese të dosjes së çështjes. Prandaj, në bazë të Nenit 308A, Paragrafi (15) i KPPK, Gjykata urdhëron që Marrëveshja mbi Fajësinë të dorëzohet në Gjykatë dhe të caktohet një seancë për datën 21 tetor 2010.

Marrëveshja mbi Fajësinë është dorëzuar në Gjykatë në të njëjtën ditë, më 20 tetor 2010.

D. DËNIMI

Më 21 tetor 2010 trupi gjykues dëgjoi argumentet e të gjitha palëve lidhur me dënimin. Palët paraqitën rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Pala e Lënduar Liridon Geci dhe Përfaqësuesi i tij Ligjor, Agim Lushta nuk morën pjesë në seancë. Pas këshillimit, Trupi Gjykues shpalli dënimin në bazë të Nenit 308A, Paragrafi (15) të KPPK.

Kur u vendos sanksioni penale Gjykata mori parasysh si qëllimin e përgjithshëm të dënimit – që është të ndalojë veprimtaritë e rrezikshme shoqërore duke parandaluar të tjerët nga kryerja e veprave të ngjashme penale, dhe qëllimin specifik – të parandalojë kryesin e veprës nga ri-kryerja e veprës penale. Në përcaktimin e kohëzgjatjes së dënimit, Gjykatës iu desh të vlerësonte të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues, sipas Nenit 64, Paragrafi (1) të KPK.

Gjykata konsideroi si rrethanë lehtësuese faktet e mëposhtme: Përpara incidentit, më herët në të njëjtën ditë, Kushtrim Haziraj ishte rrahur nga anëtarët e familjes Geci, gjë e cila ishte raportuar përkatësisht në polici. Nëpërmjet xhaxhait të tij, ai pastaj bëri një përplasje për t'u pajtuar me familjen Geci, gjë e cila fatkeqësisht nuk e parandaloi përplasjen e mëvonshme mes familjeve dhe të shtënat. Megjithatë, Kushtrim Haziraj, kreu vrasjen e Jashar Gecit me qëllim jo të drejtëpërdrejtë ose eventual. Ai ka treguar keqardhje të thellë për veprimet e tij, që i mori jetën Jashar Gecit, dhe për vuajtjen e familjes Geci. Ai e pranoi fajësinë për të tri akuzat. Gjykata mori në konsideratë, po ashtu, faktin që ai ka kaluar një kohë tejet të gjatë, për mbi tri vjet, në paraburgim paragjyqësor, për shkak të trazirave dhe mbylljes së Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës më mars të vitit 2008.

Gjykata konsideroi si rrethana rënduese që – pavarësisht nga fakti që ai ishte i rehabilituar në datën kur u krye vepra penale – dënimet e tij të mëparshme, së bashku me çështjen në fjalë, tregojnë tendencën e tij për t'i zgjidhur problemet në mënyrë të dhunshme, faktin që i ndjeri Jashar Geci duhet të mbante gruan dhe fëmijët, dhe faktin që gjatë një veprimi gjatë ngjarjes kritike, Kushtrim Haziraj kreu tri vepra penale.



Për veprën penale të Vrasjes, ligji parasheh një dënim prej të paktën pesë vitesh burgim, sipas Nenit 146 të KPK, por edhe një maksimum prej jo më shumë se 20 vitesh, sipas Nenit 38, Paragrafi (1) të KPK. Duke marrë në konsideratë si rrethanat lehtësuese, ashtu edhe ato rënduese, trupi gjykues vendosi të japë një dënim prej 10 vitesh burgim për këtë veprë penale.

Për veprën penale të Tentativës për Vrasje, sipas Nenit 146 të lexuar me Nenin 20 të KPK, dënimi minimal është i njëjtë, por dënimi maksimal nuk duhet të jetë më i gjatë se tri të katërtat e dënimit maksimal të përcaktuar për veprën penale të Vrasjes, që është maksimumi 15 vjet. Trupi gjykues e pranoi dënimin e propozuar prej 4 vitesh burgim dhe e shpalli atë dënim. Megjithëse, sipas Nenit 308A, Paragrafi (1), Pika (i) e KPPK, dënimi i rekomanduar nuk duhet të shkojë nën minimumin e përcaktuar nga ligji, duke marrë në konsideratë rrethanat e kryerjes së veprës penale, siç janë shpjeguar në gjendjen faktike të Marrëveshjes mbi Fajësinë dhe shpjegimit të dhënë nga Prokurori Publik, gjatë seancës së datës 21 tetor 2010, trupi gjykues e pranoi atë si një klauzolë të veçantë në Marrëveshjen mbi Fajësinë që siguron dënimin lehtësues, sipas Nenit 66, Paragrafi (3) të KPK.

Për veprën penale të Pronësisë, Kontrollit, Posedimit apo Përdorimit të Paautorizuar të Armëve, sipas Nenit 328, Paragrafi (2) të KPK, ligji parasheh një dënim nga 1 deri në 8 vjet burgim, ose një gjobë. Trupi gjykues vendosi dënimin me 1 vit burgim.

I akuzuari kreu tri vepra penale. Sipas rregullave të përlogaritjes së dënimit unik, dënimi unik duhet të jetë më i lartë se çdo dënim individual, por jo aq i lartë sa shumat e dënimeve të dhëna. Trupi gjykues vendosi dënimin unik prej 13 vjetësh burgim, sipas Nenit 71, Paragrafët (1) dhe (2), Pika 2) të KPK.

I akuzuari Kushtrim Haziraj ka qenë në paraburgim që më 22 gusht 2007. Kjo periudhë kohore duhet të përlogaritet në dënimin me burgim të caktuar nga gjykata, sipas Nenit 73, Paragrafi (1) të KPK.

E. LIGJI I APLIKUESHËM

Veprat penale janë kryer më 19 gusht 2007. Në atë kohë, Ligji i Përkohshëm Penal i Kosovës, që hyri në fuqi më 6 prill 2004, ishte ligji i aplikueshëm. Sipas Nenit 2, Paragrafët (1) dhe (2) të KPPK, ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprave penale, do të aplikohet ndaj kryesit të veprave penale, përveç se kur ligji i ri është më i favorshëm për të akuzuarin. I akuzuari deklaroi fajësinë për veprat penale sipas KPPK.

Megjithatë, disa ndryshime, duke përfshirë institucionin e “Marrëveshjes së Fajësisë” u prezantuan në Kodin e Proçedurës Penale të Kosovës me anë të Ligjit Nr. 03/L-003 që hyri në fuqi më 6 janar 2009, si edhe me anë të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, që u ndryshua me anë të Ligjit Nr. 03/L-002, që hyri në fuqi më 6 janar 2009. Sigurisht, dispozitat lidhur me marrëveshjen e fajësisë, mund të aplikohen vetëm me anë të referencës ndaj ligjeve “të reja”, Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe Kodit të Proçedurës



Penale të Kosovës (KPPK). Prandaj, Kodi Penal i Kosovës është më favorizues për të akuzuarin dhe Gjykata i referohet këtij ligji në Aktgjykimin e saj lidhur me dënimin.

F. KONFISKIMI

Gjykata konfiskoi armën (një AK-47, kalibri 7,62, me numër serie 039575) e cila ishte përdorur për kryerjen e veprave penale, sipas Nenit 60, Paragrafi (1) dhe Nenit 328, Paragrafi (5) të KPK.

G. SHPENZIMET

Gjykata e detyron të akuzuarin të riimburojë shpenzimet e procedurës penale, sipas Nenit 102, Paragrafi (1) të KPPK, me përjashtim të shpenzimeve lidhur me përkthimin gojor dhe me shkrim gjatë gjitha procedurës penale. Një vendim i veçantë do të dorëzohet nga Gjykata lidhur me shpenzimet, pasi Gjykata të marrë të dhëna të tilla, në bazë të Nenit 100, Paragrafi (2) të KPPK.



**Proçesmbajtëse
Tara Khan**

**Kryetare e Trupit Gjykes
Hajnalka Veronika Karpati**

Anëtarët e Trupit Gjykes: Caroline Charpentier

Nikolay Entchev

Këshilla Ligjore:

Ky aktgjykim që ka të bëjë me këtë dënim, mori formë të prerë ditën kur u shpall, meqë nuk bie nën Nenin 308A, Paragrafi (8), Pika 1 e KPPK.

**Proçesmbajtëse
Tara Khan**

**Kryetare e Trupit Gjykses
Hajnalka Veronika Karpati**

¹ Versioni shqip ka një faqe më tepër, në të cilën emrat e Kryetarit të Trupit gjykses dhe Proçesmbajtësi janë përsëritur.

